



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**MINISTRIA E DREJTËSISË**  
**DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PËRMBARRIMIT**

**ANALIZË E VEPRIMTARISË SË SHËRBIMIT PËRMBARRIMOR  
GJYQËSOR  
SHTETËROR, PËR VITIN 2015.**

Shërbimi përmbarrimor Gjyqësor Shtetëror në veprimtarinë e tij ka patur si qëllim sigurimin e transparencës së plotë ndaj publikut, si dhe thjeshtimin sa më shumë të shërbimeve të ofruara. Ekzekutimi i vendimeve gjyqësore është një shërbim i rëndësishëm publik, e sigurisht është e drejtë e publikut të monitorojë e ta kontrollojë atë në cdo veprim të tij.

Zyrës Përmbarrimore Tiranë, si një zyrë e cila veçohet për nga numri i lartë i çështjeve në ekzekutim, nga DPP i është përshtatur dhe vënë në shërbim të publikut ambjent që shërben si zyrë informacioni, duke treguar një interes të veçantë në lidhje me kërkesat e qytetarëve për të dhënë sqarimet e duhura, si dhe për të mundësuar kushte optimale për realizimin e ekzekutimeve me objekt «takim me fëmijë».

Gjithashtu, në funksion të rritjes së transparencës, funksionon rregullisht faqja elektronike zyrtare e Drejtorisë së Përgjithshme, ku pasqyrohen të dhëna lidhur me kuadrin ligjor për përmbarrimin, si dhe veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutivë nga ky shërbim.

Opinionin publik është forma më e mirë e kontrollit ndaj punës së përmbarruesve gjyqësore dhe ne duhet të punojmë në drejtim të rritjes së mëtejshme të transparencës së shërbimit përmbarrimor gjyqësor shtetëror ndaj publikut.

Në këtë kontekst, një rol thelbësor do të luante dixhitalizimi i sistemit, me qëllim aksesimin online të tij nga palët e interesuara.

Gjithashtu, në zbatim të dipozitave ligjore është mundësuar rritja e nivelit të ekzekutimit të titujve ekzekutivë (mesatarisht 200 të tillë për çdo përbarues), respektimi i procedurave përbarimore, respektimi i afateve, standartet në komunikim me palët, detyrimet për arsyetimet/argumentimet ligjore dhe profesionale të vendimeve nga ana e përbaruesve gjyqësore.

Në këtë kontekst, vlen të përmendet rasti i Agjencisë së Trajtimit të Kredive. Në kohë rekord, u identifikuan të gjitha çështjeve me palë kreditore – ATK, u realizua rivënia në ekzekutim me përparësi të këtyre çështjeve, në funksion të ndjekjes dhe respektimit të afateve procedurale për ekzekutimin e tyre.

Referuar të dhënave statistikore për këtë grup çështjesh rezultojnë të jetë shlyer tërësisht detyrimi për një pjesë të konsiderueshme të tyre dhe vijon të jetë në proces shlyerje për shumë tituj të tjerë ekzekutiv.

**Nëpërmjet fakteve dhe shifrave do të parashtrij veprimtarinë e ekzekutimit të titujve ekzekutiv dhe rezultatet e arritura, si më poshtë:**

- 42 410 çështje janë regjistruar për ekzekutim
- 1 922 çështje në ekzekutim me afate të plotësuara
- **9 229 çështje janë ekzekutuar**
- 1 705 çështje janë pushuar
- 25 396 çështje në ekzekutim brenda afateve procedurale
- 66 çështje të refuzuara
- 942 çështje të pezulluara me vendim gjykate
- 228 çështje të janë pushuar për shkak të shfuqizimit të urdhërit ekzekutiv.
- **12 104 çështje që u është dhënë zgjidhje ligjore**

***Numri i çështjeve përbarimore të ekzekutuara në vitin 2015 është 9229 (e llogaritur referuar sasisë së titujve ekzekutiv të planifikuara për tu ekzekutuar në 12 mujorin, të deklaruar në Deklaratën e Politikës për Shërbimin Përbarimor Gjyqësor Shtetëror).***

**Të dhëna krahasuese**

**Për vitin 2013** numri i çështjeve përmbartimore të regjistruara për ekzekutim është **28 872**, të ekzekutuara është **4010**. Ndërsa numri i çështjeve **për të cilat është dhënë zgjidhje ligjore është 7072**.

**Për vitin 2014** numri i çështjeve përmbartimore të regjistruara për ekzekutim është **34 863**, të ekzekutuara është **8555**. Ndërsa numri i çështjeve **për të cilat është dhënë zgjidhje ligjore është 11 042**.

Periudha	Cështje të regjist. për ekzekutim	ÇZL	Të ekzekutuara	Perqindja e ekzekutimit
Viti 2013	28872	7072	4010	46%
Viti 2014	34 863	11042	8555	88%
Viti 2015	42 410	12104	9229	87%

Nga sa më sipër, krahasuar me të dhënat statistikore të vitit 2013 dhe 2014, evidentohet një rritje e konsiderueshme e çështjeve të regjistruara për ekzekutim, me një diferencë në rritje nga vitit në vit, konkretisht **5991** çështje më shumë të regjistruara për ekzekutim në vitin 2014 krahasuar me 2013 dhe **7547** çështje më shumë të regjistruara për vitin 2015.

Rritje e konsiderueshme konstatohet edhe në çështjet me zgjidhje ligjore krahasuar me të dhënat statistikore të vitit 2013 dhe 2014, me një diferencë në rritje nga viti në vit,

Konkretisht,

**1062** është diferenca e çështjeve që u është dhënë zgjidhje ligjore në vitin 2015 krahasuar me ato të vitit 2014 dhe me një diferencë prej **5338** çështjesh më shumë krahasuar me të dhënat e vitit 2013.

Gjithashtu, konstatohet rritje e çështjeve të ekzekutuara me një diferencë prej **674** çështje më shumë në vitin 2015, krahasuar me të dhënat e vitit 2014 dhe me një diferencë prej **5219** më shumë krahasuar me vitin 2013.

### Të dhëna statistikore për çështjet “Shteti debitor”


**Për vitin 2013** numri i çështjeve të ekzekutuara është **255**, në ekzekutim është rreth **1119**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **1427**.

**Për vitin 2014** numri i çështjeve të ekzekutuara është **545**, në ekzekutim është rreth **1108**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **1712**.

**Për vitin 2015** numri i çështjeve të ekzekutuara është **381**, në ekzekutim është rreth **962**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **1402**.

#### Totali i çështjeve të ekzekutuara dhe çështje në ekzekutim (Shteti debitor)

Numri i çështjeve	Totali i çështjeve	Çështje në ekzekutim	Çështje të ekzekutuara
Viti 2013	1427	1119	255
Viti 2014	1712	1108	545
Viti 2015	1402	962	381



## Të dhënat statistikore për çështjet “ Shteti kreditor – Agjencia e Trajtimit të Kredive


**Për vitin 2013** numri i çështjeve të ekzekutuara është **165**, në ekzekutim është **460**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **826**.

**Për vitin 2014** numri i çështjeve të ekzekutuara është **194**, në ekzekutim është **376**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **633**.

**Për vitin 2015** numri i çështjeve të ekzekutuara është **423**, në ekzekutim është **1041**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **1270**.

### Totali, të ekzekutuara dhe çështje në ekzekutim (Shteti kreditor - ATK)

Periudha	Çështje në total	Çështje në ekzekutim	Çështje të ekzekutuara
Viti 2013	826	460	165
Viti 2014	633	376	194
Viti 2015	1270	1041	423



### Të dhëna statistikore për çështjet “Shteti kreditor – të Ndryshme”

**Për vitin 2013** numri i çështjeve të ekzekutuara është **1214**, në ekzekutim është **5285**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **7694**.

**Për vitin 2014** numri i çështjeve të ekzekutuara është **2199**, në ekzekutim është **6502**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **9975**.

**Për vitin 2015** numri i çështjeve të ekzekutuara është **3528**, në ekzekutim është **8364**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **12841**.

### Totali, çështje të ekzekutuara dhe çështje në ekzekutim (Shteti kreditor – Të ndryshme)

Periudha	Totali i çështjeve	Çështje në ekzekutim	Çështje të ekzekutuara
Viti 2013	7694	5285	1214
Viti 2014	9975	6502	2199
Viti 2015	12841	8364	3528

### Të dhëna statistikore për çështjet “Detyrime në të holla dhe Kontraktuale private”

Për vitin 2013 numri i çështjeve të ekzekutuara është **554**, në ekzekutim është **3611**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **5283**.

Për vitin 2014 numri i çështjeve të ekzekutuara është **699**, në ekzekutim është **3303**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **4223**.

Për vitin 2015 numri i çështjeve të ekzekutuara është **1032**, në ekzekutim është **3185**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **4173**.

### Totali, të ekzekutuara dhe çështje në ekzekutim (Detyrime në të holla dhe kontraktuale private)

Periudha	Totali i çështjeve	Çështje në ekzekutim	Çështje të ekzekutuara
Viti 2013	5283	3611	903
Viti 2014	4223	3303	699
Viti 2015	4173	3185	1032

## Të dhëna statistikore për çështjet “Gjoha penale & shpenzime procedurale”

Për vitin 2013 numri i çështjeve të ekzekutuara është **1461**, në ekzekutim është **10141**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **12799**.

Për vitin 2014 numri i çështjeve të ekzekutuara është **4914**, në ekzekutim është **10872**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **17799**.

Për vitin 2015 numri i çështjeve të ekzekutuara është **5147**, në ekzekutim është **13662**, dhe totali i çështjeve të regjistruara për ekzekutim është **21254**.

### Totali, të ekzekutuara dhe çështje në ekzekutim (gjoha penale & shpenzime procedurale)

Periudha	Totali i çështjeve	Çështje ne ekzekutim	Çështje të ekzekutuara
Viti 2013	12799	10141	1461
Viti 2014	17799	10872	4914
Viti 2015	21254	13662	5147

Specifikë e veçantë që lidhet me ekzekutimin e çështjeve më lart, ka të bëjë me vështirësitë që vijnë për shkak të informacioneve të mangëta që mbart dokumentacioni i përcjellë pranë Zyrave Përmbartimore, e që ka të bëjë me gjeneralitete të paplota dhe mungesë të adresës së Debitorit.



**Të dhënat statistikore për çdo zyrë vendore lidhur me çështjet në total, çështjet në ekzekutim, të ekzekutuara dhe çështje të cilave u është dhënë zgjidhje ligjore, si më poshtë:**

<b>Nr</b>	<b>Zyra Përmbartimore</b>	<b>Totali i çështjeve</b>	<b>Çështje në ekzekutim</b>	<b>Të ekzekutuara</b>	<b>Çështje me zgjidhje ligjore</b>
1	<b>Berat</b>	1570	809	713	761
2	<b>Dibër</b>	1299	713	366	536
3	<b>Durrës</b>	4429	3840	561	577
4	<b>Elbasan</b>	3924	2591	1016	1247
5	<b>Fier</b>	2154	1381	607	737
6	<b>Gjirokastrër</b>	1000	754	233	236
7	<b>Kavajë</b>	842	600	126	135
8	<b>Përmet</b>	215	96	65	111
9	<b>Korçë</b>	2324	1526	522	686
10	<b>Krujë</b>	701	397	204	276
11	<b>Kukës</b>	1003	721	241	277
12	<b>Kurbin</b>	853	515	249	300
13	<b>Lezhë</b>	1018	453	399	536
14	<b>Lushnjë</b>	778	540	199	218

15	<b>Mat</b>	776	567	168	187
16	<b>Pogradec</b>	1349	690	532	923
17	<b>Pukë</b>	570	224	136	270
18	<b>Sarandë</b>	3051	734	242	-(te transferuar a 2075)
19	<b>Shkodër</b>	1637	815	418	818
20	<b>Tiranë</b>	9987	7912	1724	1885
21	<b>Tropojë</b>	311	145	117	128
22	<b>Vlorë</b>	2619	1295	680	950

Konstatohet ngarkesë e lartë e çështjeve në ekzekutim për zyrat përbarimore

Tiranë përkatësisht me 9987 çështje,	(14 Përbarues)
Vlorë - 2619,	(4 Përbarues)
Elbasan - 3924,	(3 Përbarues)
Durës - 4209,	(4 Përbarues)
Fier – 2154,	(3 Përbarues)
Korça – 2154,	(3 Përbarues)
Pogradec - 1349 etj.	(1 Përbarues)

Kanë numër të lartë të çështjeve të ekzekutuara dhe atyre që u është dhënë zgjidhje ligjore

Zyrat Përbarimore, Elbasan, 1016 çështje të ekzekutuara dhe 1247 çështje me zgjidhje ligjore;

Zyra Përmbairimore, Berat, 713 çështje të ekzekutuara dhe 761 çështje me zgjidhje ligjore,

Zyra Përmbairimore Pogradec, 532 të ekzekutuara dhe 923 me zgjidhje ligjore

Zyra Përmbairimore Fier, 607 të ekzekutuara dhe 737 me zgjidhje ligjore

Zyra Përmbairimore Korçë, 522 të ekzekutuara dhe 686 me zgjidhje ligjore. etj.

<b>Krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore</b>	<b>Vlera në Lekë</b>
Shpenzime buxhetore faktike	100093201
Të ardhura të derdhura në buxhetin e shtetit	250105088

**Krahasimi i të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore viti 2015**  
Shërbimi Përmbairimor Gjyqësor Shtetëror

